

Z. Saimir Plaku ka lindur në qytetin e Kuçovës, më datë 29 Maj 1983.

Ka kryer studimet e larta në Universitetin e “Pizës” në Itali, gjatë viteve 2004-2008 duke u kualifikuar në Bachelor “Laurea Triennale” në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, (Histori dhe Politikë, Politika Ekonomike, Doktrinë Politike). Më pas, gjatë periudhës Prill 2008–Korrik 2008 ka ndjekur kurse intensive mbi Europën Qendrore në Universitetin e “Gyorit Hungari Egyetem 1,9026 Gyor”, Hungari. Z. Saimir Plaku ka kryer praktikë për periudhën Tetor-Nëntor 2009 në Departamentin e Europës Juglindore, NATO, OSCE dhe në marrëdhëniet midis EU-Shqipërisë në titullin Stage, Asistent Specialist.

Studimet pas universitare i ka kryer në Univeristetin e “Pizës” Itali gjatë periudhës Nëntor 2008-Dhjetor 2011 duke u kualifikuar në rang kombëtar dhe ndërkombëtar në “Laurea Magistrale” në Politikë e Marrëdhënie Ndërkombëtare”. Z. Plaku ka ndjekur trajnimin në fushën Diplomatieke “Liderët e Ardhshëm të Ballkanit”, në Graz University, Austri.

Z. Plaku ka eksperiencë të institucione të ndryshme. Në vitin 2011 ka punuar si “supervisor” në Gremlin Club Ltd Apple print, 9026 Gyor, Hungari. Në periudhën 2012-2021 ka punuar si “Administrator”, pranë subjektit “Rizai” Sh.p.k Berat. Në periudhën 2013-2017, ka drejtuar Zyrën Vendore të punësimit Kuçovë. Në vitin 2015, Z. Plaku, ka qenë Anëtar i Këshillit, në Këshillin Bashkiak Kuçovë. Në periudhën 2015-2019, ka qenë “Anëtar” i Delegacionit Shqiptar në Këshillin e Europës, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Europës, Strasbourg, Francë. Në periudhën 2018-2019 ka qenë Zv/Kryetar I Këshillit të Qarkut Berat. Në periudhën 2020-2021, ka qenë Anëtar i Këshillit, në Këshillin e Qarkut Berat. Në vitin 2021 ka ushtruar detyrën “Drejtori i Përgjithshëm”, në Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Prej vitit 2022, Z. Plaku, drejton Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Berat.